

VE N D I M
Nr. 93 Date 06.08. 2008

**PER NJE NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR.61, DATË 02.11.2007 “PER DHENIEN E LICENSES PER
NDERTIMIN DHE SHFRYTEZIMIN E CENTRALEVE ELEKTRIK ME ERE DHE
PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE”**


Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa a, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 te Ligjit nr.8485 date 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.08.2008, mbasi shqyrtoi kerkesen e shoqerise HERA sh.p.k per shtyrjen e afateve te percaktuara ne Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 61 date 02.11.2007 “Per dhenien e licenses per ndertimin dhe shfrytezimin e centraleve elektrik me ere dhe prodhimin e energjise elektrike ” dhe konsideroi te drejte kerkesen e shoqerise HERA sh.p.k,

Vendosi

1. Ne vendimin Nr. 61, date 02.11.2007 “Per dhenien e licenses per ndertimin dhe shfrytezimin e centraleve elektrik me ere dhe prodhimin e energjise elektrike ” behen keto ndryshime :
 - ne piken 1 afati prej 9 muaj ndryshohet dhe behet 15 muaj,
 - ne piken 4 afati prej 36 muaj ndryshohet dhe behet 42 muaj,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



2.Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes ne fuqi te vendimit te Bordit te Komisionereve nr. 61 date 02.11.2007.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari I ERE-s
Bujar Nepravishta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve

